

EDICIONI I TRETË I SHKOLLËS DIMËRORE

Për të tretin vit radhazi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi shkollën dimërore me 61 punonjësit rinorë nga 61 bashkitë e vendit. **Përgjatë 3 ditëve, punonjësit rinorë u trajnuan për përcaktimin e prioriteteve për rininë në çdo bashki, për zhvillimin e strategjive për përmirësimin e kontributit të tyre në drejtim të zhvillimit lokal dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë, si dhe për rritjen e aftësive dhe kompetencave të tyre.**

Ndër të tjera, punonjësit rinorë trajnuan çështje të ndryshme rreth Strategjisë Kombëtare të Rinisë, politikave rinore, shkrimit të projekteve dhe Këshillave Vendor Rinor (KVR), me qëllim diskutimin e mënyrave më të mira si kjo strukturë mund të shërbejë për të fuqizuar rolin e të rinjve në proceset politikëbërëse si dhe përfshirjen e më shumë aktiviteteve për të rinjtë në çdo bashki, si dhe përcaktuan objektivat për vitin 2024



PËRMBYLLET THIRRJA E TETË E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS, 314 TË RINJ TË CERTIFIKUAR

Më 14 dhjetor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për të kremtuar realizimin e Thirrjes së tetë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës zhvilloi ceremoninë përmbyllëse, me pjesëmarrjen e praktikantëve të cilët kanë përmbyllur me sukses ciklin e programit. Përgjatë ceremonisë, të rinjtë u pajisën me certifikata, të njohura nga DAP si përvojë pune, si dhe ndanë me njëri-tjetrin eksperiencat e fituara gjatë praktikës së tyre në institucionet e administratës shtetërore, në shoqëri tregtare dhe në organizata jo-fitimprurëse, qoftë në aspektin profesional, akademik apo edhe atë personal, duke krijuar kështu njohje dhe ura të forta bashkëpunimi.

Në Thirrjen e VIII të Programit të Praktikave të Punës kanë aplikuar 1327 të rinj, nga të cilët 314 përfunduan me sukses praktikën tre mujore.



MBAHET KONFERENCA DY DITORE "FUQIZOHEMI SË BASHKU – KËSHILLAT VENDOR RINOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR"

Në kuadër të qëllimit të parë të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, për ngritjen dhe fuqizimin e Këshillave Vendor Rinor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me UNDP Albania realizoi konferencën dy ditore "Fuqizohemi së bashku – Këshillat Vendor Rinor në Ballkanin Perëndimor", me pjesëmarrjen e 80 të rinjve shqiptarë përfaqësues të Këshillave Vendor Rinor dhe 20 të rinjve nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. **Përgjatë dy ditëve të Konferencës, panelistët ndanë eksperiencën pozitive të shteteve respektive për politikëbërjen për rininë me fokus kryesor integrimin në Bashkimin Evropian.**

Konferenca "Fuqizohemi së bashku – Këshillat Vendor Rinor në Ballkanin Perëndimor" u zhvillua në sajë të projektit "Të Rinjtë për Gjithpërfshirje, Barazi dhe Besim" i cili realizohet nga UN Albania, UNDP Albania dhe UNFPA Albania në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët



FINALIZIMI I PROJEKTIT "FUQIZOHU NË BOTËN DIGJITALE", MBËSHTETUR NGA THIRRJA E DYTË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në eventin përmbyllës të projektit "Fuqizohu në botën digjitale", zbatuar nga Qendra A.L.T.R.I me mbështetjen financiare nga Thirrja e Dytë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë. **Gjatë zbatimit të projektit, të rinjtë janë trajnuar mbi botën digjitale, "të fshehtat e saj", si dhe për mënyrat efektive për t'u bërë pjesë aktive e saj.** Njohuritë e fituara gjatë trajnimeve, i kanë kthyer në produkte të prekshme që shërbejnë për rivitalizimin e qytetit të Tiranës, Shkodrës dhe Lushnjës, si dhe promovimin e produkteve cilësore dhe të shëndetshme për konsumim të përditshëm, apo edhe mënyra alternative për prodhimin e energjisë.



ZHVILLOHET AKTIVITETI "UNDER 30" NË KUADËR TË DITËS KOMBËTARE TË RINISË

Një event special u organizua me rastin e Ditës Kombëtare të Rinisë nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me mbështetjen e GIZ Albania, në parkingun nëntokësor tek Sheshi "Skëndërbej". Rreth 100 organizata, institucione, startup-e, biznese, universitete që punojnë me të rinjtë ose që drejtohen prej tyre, u bënë pjesë e Eventit "Under 30" (<30). Në këtë aktivitet shumë dimensional të rinjtë patën mundësinë të vizitojnë standat e institucioneve publike dhe private, organizatave jo-fitim prurëse, universiteteve etj., për t'u njohur me shërbimet dhe mundësitë që ata ofrojnë për të rinjtë në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Gjithashtu, gjatë aktivitetit u zhvilluan panele të ndryshme diskutimi ku pjesë e këtyre paneleve ishin edhe Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri z. Silvio Gonzato, Drejtori i Bankës Botërore në Shqipëri, z. Emanuel Salinas; Ambasadori Gjerman në Shqipëri, Z. Karl Bergner dhe Nënkretarja e Bashkisë Tiranë, znj. Keti Luarasi. Panelistët ndanë me të rinjtë programet që ofrojnë për ta, si dhe fjalë motivuese e mesazhe frymëzuese për të rinjtë për të vazhduar rrugëtimin plot ngjyra që kanë nisur për fuqizimin dhe plotësimin e ëndrrave të tyre.



INAUGUROHET QENDRA RINORE PETRELË, QENDRA RINORE KAMËZ DHE BIBLIOTEKA KAMËZ, SHPALLET THIRRJA E TRETË PËR GRANTE PËR INFRASTRUKTURË RINORE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në inaugurimin e qendrës rinore në Petrelë dhe bibliotekës së re e qendrës rinore në Kamëz, të rikonstruara këto të fundit me mbështetjen financiare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, me qëllim rritjen e hapësirave rinore ku të rinjtë mund të realizojnë aktivitete që rrisin përfshirjen në jetën sociale, por edhe ndikojnë në zhvillimin personal të tyre.

Më 8 dhjetor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë shpalli thirrjen e tretë për projekt-propozime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me anë të së cilës do të mbështeten të paktën 5 njësi të vetëqeverisjes vendore deri në vlerën 10.000.000 lekë për të ndërtuar hapësira rinore, qendra rinore dhe biblioteka për të rinjtë.



KONSTITUOHET LEGJISLATURA E TRETË E PARLAMENTIT TË TË RINJVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në **konstituimin e Legjislaturës së tretë të Parlamentit të të Rinjve**, ku me anë të një procesi transparent dhe demokratik 140 deputetët e rinj votuan për kryetaren dhe nënkryetarët, që në dy vitet e ardhshme do të jenë zëri i bashkëmoshatarëve, por edhe do të bëhen së bashku për sfida më madhore që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë.



1165 TË RINJ PJESË E PROGRAMIT TË KODIMIT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në diplomimin e tre klasave Software Tester nga akademja SDA by Protik, të cilët janë bërë pjesë e Programit të Kodimit me mbështetje financiare nga qeveria.

Programi i Kodimit ka filluar implementimin më 23 janar 2023 dhe pjesë e tij janë bërë gjashtë akademi të njohura nga AKPA, që ofrojnë kurse 4-12 mujore me mbështetje 50% ose 100% nga qeveria, duke i dhënë mundësi çdo individi 16 vjeç e sipër të përmirësojë aftësitë digjitale bashkëkohore, por edhe të mësojë një profesion të ri në raport me zhvillimet e vullshme të tregut të punës.

Synimi i qeverisë për vitin 2023 ishte të diplomoheshin në kursin e kodimit 1000 të rinj. Deri më tani janë 5242 aplikime dhe 1165 të rinj që janë bërë pjesë e programit të kodimit, duke tejkaluar numrin e përcaktuar për vitin 2023.

